

## Zgjedhjet e Parlamentare ne Shqiperi, a ka ndonjë ndryshim në perspektivë?

'Përfundimi është se pavarësisht dy partive kryesore, që garojnë për këto zgjedhje PD dhe PS, faktori kyç në formimin e Qeverisë së re, është Lëvizja Socialiste për Integrim dhe aleatët e saj'

*Nga Claude MONIQUET Presidenti i ESISC (Qendra strategjike Europiane e inteligjencës)*

### *Në vend të parathënies*

Shqipëria është tashmë pjesë e strukturave të NATO-së më të drejta të plota. Vetëm disa muaj më parë ajo ka aderuar për të marr statusin kandidat në strukturat e Bashkimit Europian.

Ngjarje të tilla për shtetet të vogla si ato të Ballkanit kanë një rëndësi shumë të veçantë, duke pasur parasysh që kanë qene vende të "humbura" në një diktaturë të egër komuniste.

Kur mbeten më pak se një javë nga zgjedhjet e përgjithshme elektorale, klasa politike në pushtet vazhdon të pretendojë dhe të premtojë ndryshim. Për më tepër, në emër të "ndryshimit" dy partitë kryesore ajo Socialiste dhe Demokratike institucionalizuan bipolarizimin e sistemit elektorale. Reforma elektorale cila u pretendua të bëhej për ti dhënë fund

fragmentimit të skenës politike, por në fakt rezultoi në monopolizimin e sistemit zgjedhor nga 2 partitë politike, PS dhe PD. Shume personalitete të politikës shqiptare të 20 viteve të fundit u perjashtuan nga listat zgjedhore.

"Ndryshimi"- Lajtmotivi i fushatës elektorale

Duke u mbështetur në fushatën e vetë kryetarit të Partisë Demokratike Sali Berisha, ndryshimi është një premtim i gjithmonshëm. Cuditërisht, në këtë fushatë elektorale të dy koalicionet kanë si fjalë kyçe "ndryshimin".

Klasa politike e Shqipërisë bën thirrje për ndryshim, ndërkohë që individët e thjeshtë janë të shkatërruar nga ndryshimet shoqërore-politike dhe janë duke kërkuar stabilitet.

Lideri i Partisë Demokratike pasqyron arritjet e Qeverisë së tij të cilën e drejton që ga viti 2005, premtion dhe ndryshime kolosale në të ardhmen. Ndryshime të cilat ai i premtion në një moment kur shteti është duke kaluar një periudhë mjaft të vështirë ekonomike.

Edi Rama nuk ka dhënë ende dorëheqjen e tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës, duke ndërjerë frikën e humbjes së zgjedhjeve, ndërkohë që dhe ai ndryshimin e shikon tek puna e tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës.

Fillimi i kësaj fushate elektorale nga të dy liderët e partive kryesore asaj të majtë dhe të djathtë është kthyer në një kopjim mesazhesh elektorale duke lënë harruar premtimet për ndryshim. Akuzat e ndërsjellat, në të vërtetë janë ndryshimi që po sjell kjo fushatë. Kryetari i Partisë Socialiste Rama ka hedhur akuza mjaft të rënda për figurën e Sali Berishës duke përfshirë dhe familjen e kryeministrit aktual.

Ndryshimi i Sali Berishës në këtë fushatë qëndron në faktin se ai po akuzon gjithmonë e më shumë kryetarin e Bashkisë si të përfshirë në afera korruptive duke shfrytëzuar detyrën e tij.

Ne gjithashtu duhet të përmendim irracionalitetin e njeriut të fortë të Partisë Socialiste duke mos qenë në krye të listës së kandidatëve për deputet, ndërkohë që ai pretendon që të jetë dhe kryeministri i ardhshëm i Shqipërisë.

Partia demokratike ka zgjedhur që të ketë prezentë në listat e saj njerëz të cilët nuk janë shumë të njohur

në jetën politike, duke harruar politikanët të cilët e kanë themeluar këtë parti. Partia Socialiste duket sikur do të bindë votuesit se po mbështet intelektualët dhe progresistët, ndërkohë që në listën e kandidatëve për deputet ajo ka vendosur biznesmen dhe individ me një të kaluar të dyshimtë. Listat e deputetëve kanë mangësi të liderëve historikë si Fatos Nano nga PS dhe largimi i Aleksandër Biberaj, Preç Zogaj dhe Besnik Mustafa nga PD.

Gjatë kësaj fushate mediat kanë abuzuar me kohën e partive të vogla duke u fokusuar vetëm në aktivitetet e partive të mëdha.

### ***Konkluzioni***

Përfundimi është se pavarësisht dy partive kryesore, që garojnë për këto zgjedhje PD dhe PS, faktori kyç në formimin e qeverisë së re dhe i cili do të përcaktojë fitoren e 28 Qershorit është Lëvizja Socialiste për Integrim dhe aleatët e saj.

Skenari më i mundshëm në këto zgjedhje, do të ishte një koalicion mes liderëve të PS, Edi Rama dhe atij të LSI-së, Ilir Meta. Nese do të jetë kështu, atëherë do t'i vinte fundi kohës së Sali Berishes, dhe ironikisht ky do të ishte ndryshimi i rradhës për Shqipërinë.

[stampa](#) | [chiudi](#)